

LAJME / KRONIKA E ZEZË

Dhunë familjare, kanosje e sulme, Policia e Kosovës arreston shtatë persona për 24 orë

14 orë



Policia e Kosovës ka arrestuar shtatë persona gjatë 24 orëve të fundit për dhunë në familje, kanosje dhe sulm.



Tre persona janë arrestuar për dhunë familjare, dy prej të cilëve ishin grindur mes vete për të disatën herë, ndërsa në Gjakovë është arrestuar një i dyshuar mashkull kosovar pasi i njëjti nën ndikimin e alkoolit kishte kanosur verbalisht me vrasje viktimën femër, bashkëshorten e tij jashtë martesore.



Kurse, dy raste të kanosjes janë regjistruar në 24 orëve e fundit, prej të cilëve raste tre persona janë arrestuar, kurse është arrestuar edhe një person për sulm ndaj një tjetri.

Detajet nga raporti i Policisë së Kosovës:

SULM – Prishtinë 18.10.2020-13:00. Është arrestuar i dyshuari m/kosovar, pasi që i njëjti ka sulmuar fizikisht viktimën m/k. Viktima ka pranuar tretman mjekësor ndërsa me vendim të prokurorit i dyshuari dërgohet në mbajtje.

DHUNË FAMILJARE– Prishtinë 17.10.2020-21:00. Janë arrestuar dy të dyshuar m/kosovar , të cilët pas një mosmarrëveshje ishin grindur në mes veti. Të dyshuarit për shkak se kanë qenë recidivistë të veprës penale, me vendim të prokurorit, pas intervistimit janë dërguar në mbajtje.

KANOSJE– Rr. “Rrahim Beqiri”, Prishtinë 18.10.2020-13:30. Janë arrestuar dy të dyshuar m/k, pasi që të njëjtit pas një mosmarrëveshje rreth një borxhi kanë kanosur njëri-tjetrin. Pas intervistimit me vendim të prokurorit të dyshuarit janë dërguar në mbajtje.

KANOSJE/ARMËMBAJTJE PA LEJE– Fshati Banjë, Istog 18.10.2020-10:35. Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar nën dyshimin se njëjti e ka kanosur me armë zjarri viktimën mashkull Kos. I dyshuari është intervistuar dhe me vendim të prokurorit është ndaluar për 48-orë. Rasti vazhdon të hetohet.

DHUNË FAMILJARE-Gjakovë 18.10.2020-13:30. Është arrestuar i dyshuari mashkull Kos. pasi që i njëjti nën ndikim të alkoolit ka kanosur verbalisht me vrasje viktimën femër Kos. bashkëshorten e tij jashtë martesore. I njëjti me vendim të prokurorit është dërguar ne mbajtje. /Telegrafi/

Shfaq statistikat COVID-19 ▾

Dhunë familjare

Policia e Kosovës

Sulm



Pa hormone e pa antibiotik – mishi më i freskët e natyral në tregun tonë vjen me 15% zbritje

Sponzorizuar

[Lexo më shumë](#)

CORONAVIRUS

[më shumë](#)

Johnson & Johnson ende nuk zbulon detajet e ndërprerjes së testit të vaksinës

Inspektorët shëndetësorë bojkotojnë punën në teren, kërkojnë shtesa në pagë

Edhe një mbyllje nga pandemia, përmbys ekonominë kosovare

Edhe personat e prekur me coronavirus votojnë në Lituani, por në “qendrat speciale” të...



TELEGRAFI sh.p.k.
Rr. Rexhep Mala, Aktash, Nr.29, Prishtinë, Kosovë
info@telegrafi.com +383 48 222 355

Partnerët



Ky portal mirëmbahet nga kompania "Telegrafi". Materialet dhe informacionet në këtë portal nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër për qëllime përfitimti, pa miratimin e drejtuesve të "Telegrafit". Për ta shfrytëzuar materialin e këtij portali obligoheni t'i pranoni Kushtet e përdorimit.

Lajme

Ekonomi

Sport

Magazina

Femra

Stili

Shendetesia

Teknologji

Auto

Fun

Radio Dukagjini

Smard

Telegrafi Jobs

Marketing

Arkiva

Për ne

Privacy policy

Na ndiqni:



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2006-2020 Portali Telegrafi